



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:093168

Datë: 09.11.2022

Numri i dokumentit: 03626822

P.nr.358/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me zyrtare ligjore, Atdhetare Bashota Krasniqi, në lëndën penale ndaj të pandehurve: V.R, për shkak të veprës penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321, par.1, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK-së), dhe S.B, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par.1, nënpar. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.623/2021 (2019:0022432), të datës 17.05.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 10.10.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, të dëmtuarit O.B, të akuzuarve: V.Rizvani dhe S.B, të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa më datë 09.11.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarve:

V.R, nga i ati K..., e ëma Rr..., e vajzërisë Sh..., e lindur me data e lindjes..., në Gjermani, ndërsa tani me vendbanim në ..., Mitrovicë Veriore, e divorcuar, nënë e një fëmije, e gjendjes së dobët ekonomike, me numwr tw letwrnjoftimit..., rome, shtetase e Republikës së Kosovës.

S.B, nga i ati M..., e ëma N..., e vajzërisë M..., i lindur me data e lindjes..., në Mitrovicë, ku edhe tani banon në ..., Mitrovicë, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, me numwr tw letwrnjoftimit..., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

I

E akuzuara V.R,

ËSHTË FAJTORE

Sepse:

Më datë 17.03.2021, rreth orës 20:30 minuta, në ..., në Mitrovicën Veriore, e pandehura me dashje i dëmton pasurin e personit tjetër, dhe atë të dëmtuarit O.B ashtu që, e njëjta pas mosmarrëveshjes që kishte pasur me të të dëmtuarin O..., në një moment ia dëmton veturën duke i këputur fshesën e parafangos dhe duke ia thyer pasqyrën e automjetit nga ana e vozitësit, e po ashtu duke ia dëmtuar çelësin e veturës të tipit S..., ngjyrë e bronzte, me targa tw regjistrimit..., me çka të dëmtuarit i është shkaktuar dëm në vlerë rreth 200 euro.

Me këtë ka kryer veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

II

I akuzuari S.B,

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Në kohën dhe vendin e cekur sikur nën piken I të aktakuzës dhe këtij aktgjykimi, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, dhe atë të dëmtuarës, V.R në atë mënyrë që pasi i ai është revoltuar si shkak i dëmit që ia kishte bërë V... në veturën e vëllait të tij, të dëmtuarit O.B, e sulmon V... me shuplaka fytyrës me çka ajo pastaj ka marr trajtim mjekësorë, ku nga ekspertiza mjekoligjore rezulton se ka pësuar lëndime të lehta trupore, dhe atë kontuzione në kokë, faqen e majtë, që si të tilla konsiderohet si dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndime të lehta trupore nga neni 185 par.1, nënpar. 1.4 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 185 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 e 495 të KPP-së, ju:

SHQIPTON

Të akuzuarës V.R,

1. Dënim me gjobë me kusht në shumë prej 400 (katërqind) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara nuk kryen vepër tjetër penale në afat prej 1 viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarin S.B,

2. Dënim me gjobë me kusht në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në afat prej 1 viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

3. Të akuzuarit obligohen që, secili veç e veç, në emër paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej nga 50 euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 30 euro, ndërsa i akuzuari S.B, në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguaj shumë prej 20 euro.

4. Pala e dëmtuara, realizimin e kërkesës pasurore -juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.623/2021 (2019:0022432), të datës 17.05.2021, ndaj të akuzuarve: V.R, për shkak të veprës penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, dhe S.B, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, me datë 10.10.2022, ashtu që në këtë seancë e akuzuara V.R e ka pranuar fajësinë për veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, Ndërsa, i akuzuari S.B nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata, pasi ka dëgjuar palët, me aktvendim procedural e ka pranuar pranimin e fajësisë nga e akuzuara V.R, ashtu që shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar vetëm për të akuzuarin S.B, ku është

dëgjuar dëshmitari O.B, janë administruar provat materiale, i akuzuari e ka paraqit mbrojtjen e tij dhe palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare, mes tjerave ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë aktakuzës kundër të pandehurve V.R dhe S.B pasi që ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer veprat penale sipas aktakuzës, e që gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se e pandehura V.R e ka kryer veprën penale e që u vërtetua edhe pranimi i fajësisë nga e akuzuara. Sa i përket të pandehurit S.B gjendja faktike u vërtetua nga provat të cilat u administruan gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku nga deklarata e të dëmtuarës V.R e po ashtu edhe nga dëshmitari O.B gjatë shqyrtimit gjyqësor, u vërtetua se tani i pandehuri e ka sulmuar të dëmtuarën V..., kjo u vërtetua pjesërisht edhe nga vet i pandehuri i cili u mundua të minimizoj pasojat e veprës penale duke u arsyetuar se lëndimet i ka shkaktuar të dëmtuarës V... nga pakujdesia e këtë e ka bërë me qëllim që t'i ikë përgjegjësisë penale. Nga ekspertiza mjekoligjore është konstatuar se e dëmtuara ka marr lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin. Mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari O.B, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbes pranë asaj që thash më lartë dhe se nuk paraqesë kërkesë pasurore juridike për kompensim dëmi.

E akuzuara V.R, në fjalën përfundimtare mbeti pranë pranimit të fajësisë, dëmin e ka kompensuar, e lus gjykatën të marrë parasysh rrethanat lehtësuese, jam e papunë, jam nënë e një fëmije 8 vjeçar për të cilin kujdesem unë, jetoj nga ndihma që marrë nga shoqëria jashtë vendit.

I akuzuari S.B, në fjalën përfundimtare e kundërshtoj fjalën e prokurorit, ngase nuk është e vërtetë që ky e ka goditur edhe në trup, por se kjo ka ndodhur padashje.

Provat e administruara:

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë, të datës 10.10.2022, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëshmitari O.B, i cili mes tjerave ka deklaruar se, mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici, duke shtuar se me V... janë në raporte miqësie ku e njëjta ka banuar në shtëpinë e tij përreth një vit. Sa i përket rastit kur S... e ka sulmuar V..., atë ditë V... është levizte përreth kerrit dhe nuk mi jepke çelësat, aty ka qenë edhe S..., pasi nuk mi jepke çelësat S... i ka thënë pse po e bënë këtë punë, pastaj V... i ka thënë që nuk t'i jap, s'ke çka bën, pastaj S... i ka ra shuplakë në faqe me dorën e djathtë në faqen e majtë. Pastaj jemi ndreq por unë kam vazhduar me flejt në kerr sepse frikësohesha me lan kerrin çel për shkak se V... i ka pas çelësat.

Pas administrimit të provave, i akuzuari S.B, e paraqiti mbrojtjen e tij, ku mes tjerave pohoj se, V... i është flugur mbrapa, i ka thënë nuk ti jap çelësat, i ka futur çelësat në hellonke dhe mu ka flugur me dy duart që të më vërsulet, unë me qëllim të mbrojtjes jam përkulur nga para që të mbrohem dhe rastësisht pa dashje me dorën e djathtë e ka goditur në faqe pa dashje, nuk ka qenë ndonjë goditje e madhe dhe nuk ka pasur për qëllim me godit.

Gjykata gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, janë administruar provat materiale, si në vijim: Raporti policor i datës 17.03.2021; Raporti policor i datës 18.03.2021; Raporti mjekësor në emër të V.R, i datës 17.03.2021; Akt-ekspertimi mjeko-ligjor i hartuar nga Dr. N.H, për të dëmtuarën V.R, i datës 29.04.2021;

Vlerësimi i gjykatës për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, për të akuzuarën V.R:

E akuzuara, V.R, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, datë 10.10.2022, e pranoj në tërësi fajësinë për veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë nga e akuzuara V.R, i propozoj gjykatës ta pranoj pranimin e fajësisë, ngase janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par.1 i KPP-së për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

I dëmtuari O.B, në lidhje me pranimin e fajësisë nga e akuzuara V..., i propozoj gjykatës ta pranoj pranimin e fajësisë, dëmi i është kompensuar, dhe nuk jam i interesuar të dënohet.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar e pandehura, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurën. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti policor i datës 17.03.2021; Raporti policor i datës 18.03.2021; Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit O.B i datës 17.03.2021 dhe 18.03.2021; Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të pandehurës V.R i datës 17.03.2021; Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të pandehurit S.B i datës 18.03.2021; Raporti i forenzikes, foto-dokumentacioni. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të tyre dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se e pandehura, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë në mënyrë vullnetare, se e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurës se pas pranimi të fajësisë, ajo nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e pandehura.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Vlerësimi i gjykatës për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, të akuzuarin S.B:

Gjykata, pasi ka dëgjuar dëshmitarët në këtë rast, ka administruar provat materiale, pretendimet e palëve, gjykata ka arritur të vërtetojë se i akuzuari S.B ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, pika 1.4 të KPRK-së.

Për gjykatën nuk ishin kontestuese fakti se më datë 17.03.2021 kishte ndodhur një mosmarrëveshje në mes të akuzuarit S.B e të dëmtuarit O.B dhe të akuzuarës V.R. Kjo kishte ardhur për shkak se të një veture ku V... ia kishte marr çelësat e veturës të dëmtuarit O... e pastaj, në këtë situata e akuzuara ia dëmton fshesën e xhamave dhe pasqyrën e veturës së të dëmtuarit. Kjo gjendje faktike vërtetohet nga pranimi i fajësisë nga e akuzuara, si në pikën I të këtij aktgjykimi.

Nuk ishte kontestuese as fakti se i akuzuari S.B, në këtë rast e kishte goditur të akuzuarën me grusht në pjesën e kokës dhe faqës së majtë. Kjo vërtetohet nda mbrojtja e të akuzuarit S.B, i cili në lidhje me këtë ka deklaruar se e ka goditur V... me dorën e djathtë në faqe. Mirëpo kjo sipas tij ka qenë padashje, duke u mbrojtur.

Nuk ishte kontestues as fakti se e akuzuara V... kishte pësuar lëndime të lehta tupore, në këtë rast. Kjo vërtetohet nga ekspertiza mjeko-ligjore, e datës 29.04.2021 e hartuar nga Dr. N.H, ku është theksuar se e dëmtuara ka pësuar dëmtime në kokë, faqen e majtë të fytyrës dhe krahun e majtë, e si tilla klasifikohen si dëmtime të lehta trupore. Po ashtu, edhe nga raporti mjekësor në emër të akuzuarës V.R, datë 17.03.2021 rrjedh se atë ditë është paraqitur për ndihmë mjekësore, e mbi bazën e të cilit raport edhe është hartuar ekspertiza.

Kontestuese në këtë çështje penale ishte vetëm fakti se i akuzuari S..., a e ka goditur me dashje apo nga pakujdesia, të akuzuarën V.R.

Gjykata nga provat e administruar në shqyrtimin gjyqësorë, ka vërtetuar se i akuzuari, ditën kritike, datë 17.03.2021, rreth orës 20:30, për shkak të një mosmarrëveshje që e kishte me të akuzuarën V.R, të njëjtën e kishte sulmuar në fytyrë, me ç`rast si pasojë e goditjes ajo pëson lëndime të lehta tupore.

Siç ka sqaruar më lartë, Gjykata faktin se i akuzuari e ka goditur të akuzuarën V... e ka vërtetuar si nga mbrojtja e të akuzuarit S..., i cili e ka pranuar se e ka goditur, po ashtu edhe nga dëshmia e të dëmtuarit O.B, i cili në lidhje me këtë rrethanë, në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësorë theksoj: “Sulejmani i ka ra shuplakë në faqe me dorën e djathtë, në faqen e majtë”. Këtë e ka pohuar edhe në deklaratën në polici. Po ashtu, edhe e akuzuara v..., në deklaratën në polici, e ka pohuar faktin se është goditur nga i akuzuari S...

Pra, nga këto prova, Gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari S.B, me dashje, pra i vetëdijshëm për veprën dhe pasojat e saj, e ka goditur të akuzuarën V..., për shkak të një mosmarrëveshje që kishte e akuzuara me vëllaun e të akuzuarit, O..., e që si rezultat i këtyre goditjeve ajo ka pësuar lëndime të lehta, siç janë konstatuar në ekspertizë.

Por, duke ju referuar mbrojtjes së të akuzuarit se kjo goditje ka qenë padashje apo nga pakujdesia, gjykata nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se ky pretendim i të akuzuarit është i pabazuar.

Asnjë nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk e mbështesin një pretendim të tillë, e përveç kësaj, mbrojtja e të akuzuarit nuk gjente mbështetje as në deklaratën e dhënë në polici, datë 18.03.2022, ku në lidhje me këtë, ka pohuar: “jo, nuk e kam godit”. Pra, i akuzuari në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësorë e pranon se e ka goditur, pro sipas tij, kjo ka qenë nga pakujdesia, ndërsa në deklaratën në polici e ka mohuar se e ka goditur të akuzuarën V....

Përveç që ishte në kundërshtim me deklaratën e tij në polici, pretendimi i të akuzuarit se kjo ka qenë nga pakujdesia nuk gjente mbështetje as në provat e tjera. Kjo për faktin se i dëmtuari O.B, në dëshminë e tij ka pohuar se S... e ka godit V... me shuplak në fytyrë, e po ashtu edhe nga deklaratat e akuzuarës V... dhënë në polici, rrjedh se ajo është goditur nga i akuzuari, në fytyrë.

Prandaj, Gjykata në tërsi iu ka besuar deklaratës së të akuzuarës dhe të dëmtuarit në lidhje me këtë rrethanë, ngase përveç që ishin në harmoni njëra me tjetrën, ato kishin mbështetje edhe në provat tjera, si në akt-ekspertimin mjeko-ligjor, nga ku rrjedh se e akuzuara V... kishte pësuar lëndime në kokë dhe në faqen e majtë të fytyrës.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në bazë të provave të administruara u vërtetua në mënyrë të

pakontestueshme se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1, nënpar. 1.3 të KPRK -së.

Sipas kësaj dispozite, pra sipas nenit Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, është përcaktuar: *“Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në:”* nënpar. 1.4 *“dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër”* dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësorë përtej çdo dyshimi vërtetohet se i akuzuari kishte ndërmarr veprimet në drejtim të kryerjes së veprës penale, ashtu që ditën kritike, datë 17.03.2021, rreth orës 20:30, pas një mosmarrëveshje në lidhje me çelsat e veturës së të dëmtuarit O..., të cilët çelësa ia kishte marr e akuzuara V..., i akuzuari S... e kishte goditur me shuplakë në fytyrë, nga e cila goditje i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupore. Po ashtu, gjykata gjen se, veprimet e të pandehurit të përshkruara si me lartë, pra goditja me grusht, ka qenë haptazi e kundërligjshëm, pasi që nuk lejohet cenimi i integritetit trupor të askujt. Gjykata rikujton se veprimet e të pandehurit në këtë rast janë të sanksionuara me ligj si vepër penale të përcaktuara, si: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1, nënpar. 1.4 të KPRK -së, e për të cilën vepër, me të njëjtin nen, është përcaktuar edhe sanksioni penale dhe atë, dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Përveç elementeve të përgjithshme, gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur edhe elementet e veçanta të veprës penale. Kjo për faktin se i akuzuari në këtë rast kishte vepruar me dashje, ashtu që, edhe pse ishte i vetëdijshëm se si rezultat i goditjes më shuplakë mund të shkaktohet pasoja, respektivisht po cenohet integriteti trupor i të dëmtuarës, i njëjti e kishte goditur në faqen e majtë, e si rezultat i goditjes edhe kishte pësuar lëndime e dëmtuara.

Prandaj, si përfundim, Gjykata, nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar për tej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga 185 par.1, nënpar 1.4 të KPRK -së.

Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit:

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës.

Në raport me të akuzuarën V.R, Gjykata nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se duke marrë parasysh rrethanat personale rezulton të jetë i gjendjes se vështirë ekonomike, se është e papunë, rrethanat familjare pasi është nënë e një fëmije 8 vjeçar për të cilin kujdeset ajo si dhe faktin se jeton nga ndihmat që merr nga shoqëria jashtë vendit , e po ashtu edhe premtimin se nuk do të përsëris veprën penale.

Ndërsa në raport me të akuzuarin S.B, si rrethana rënduese është vlerësuar mënyra dhe rrethanat si ka vepruar, pra kontributin e tij esencial ashtu që e kishte goditur atë edhe pse nuk ka pasur asnjë problem në mënyrë të drejtëpërdrejt me të. Ndërsa, rrethana lehtësuese ka vlerësuar gjendjen e tij ekonomike, ngase është i papunë, pa të ardhura dhe gjendjen e përgjithshme shëndetësore.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit si në dispozitiv ndaj të akuzuarve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu,

Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen e pandehura të përmbahet nga çfarëdo veprimi që janë të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike:

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi pala e dëmtuara ka deklaruar se nuk paraqes kërkesës pasurore juridike, në raport me pikën I të aktgjykimit. Ndërsa, në raport me pikën II, pala e dëmtuara është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika, 2.1 dhe 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe ato për ekspertizë. Ndërsa taksa për kompensim viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 e 463 të KPP-së nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.358/2021, datë 09.11.2022
2021:093168, 09.11.2022

Zyrtare ligjore
Atdhetare Bashota Krasniqi

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.